



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-SC-2025-06

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme**
Gjykatësë Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart
Gjykatës Daniel Fransen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 25 qershor 2026

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”) duke vepruar në bazë të nenit 162(2) të Kushtetutës së Kosovës,¹ neneve 3, 22(8), 44(6) dhe 48(6), (7) dhe (8) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar² (“Ligji”) dhe rregullave 193 dhe 194 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”)³ ka marrë në shqyrtim Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Vendimit mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim me Shtojcën Publike 1 (“Kërkesa”).⁴

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses I shpalli aktgjykimin dhe e dënoi z. Pjetër Shala me 18 vjet burgim, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim (“Aktgjykimi”).⁵
2. Më 29 nëntor 2024, Trupi Gjykses I lëshoi Urdhrin për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës (“Urdhri për Zhdëmtim”), me të cilin urdhëroi z. Shala t’u paguante 208.000 euro viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor, si kompensim për dëmin e shkaktuar.⁶
3. Më 14 korrik 2025, Paneli i Apelit shpalli Aktgjykimin e Apelit, ku, ndër të tjera, prapësoi pjesërisht verdiktet e fajësisë së z. Shala për pikat 1 dhe 3 “në lidhje me pjesët e tyre që bazohen në ndalimin arbitrar të dy personave dhe në torturimin e pesë

¹ Kushtetuta e Kosovës (me amendamentet I-XXIV), 5 gusht 2015.

² Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nr. 05/L-053, 3 gusht 2015.

³ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

⁴ PL002/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Vendimit mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim me Shtojcën Publike 1, 29 prill 2026 (konfidenciale). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 18 maj 2026 (F00001/RED).

⁵ KSC-BC-2024-04/F00847/RED, Aktgjykim dhe Dënim me Një Shtojcë Konfidenciale, 16 korrik 2024, para. 1125.

⁶ KSC-BC-2024-04/F00866, Urdhër për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës, 29 nëntor 2024 (konfidencial), para. 239. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 23 dhjetor 2024, F00866/RED.

personave”.⁷ Paneli i Apelit rrëzoi apelin e z. Shala “për të gjitha aspektet e tjera”,⁸ dhe la në fuqi verdiktet e fajësisë së tij për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme.⁹ Paneli i Apelit anuloi dënimet e dhëna për pikat 3 dhe 4 dhe caktoi dënimin e rishikuar me 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.¹⁰

4. Më 29 janar 2026, Paneli i Apelit lëshoi Vendimin mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim (“Vendimi mbi Apelin” ose “Vendimi i Kundërshtuar”), me të cilin rrëzoi në tërësi apelin e z. Shala kundër Urdhrit për Zhdëmtim.¹¹

5. Më 29 prill, z. Shala dorëzoi Kërkesën.

6. Më 1 maj 2026, Kryetarja lëshoi Vendimin për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme.¹²

7. Më 26 maj 2026, Mbrojtja e Viktimave dorëzoi Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Vendimit mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim me Shtojcën Publike 1 (“Përgjigja”).¹³

8. Më 28 maj 2026, Paneli lëshoi Vendimin mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit, me të cilin miratoi kërkesën e z. Shala për zgjatjen deri më 10 qershor 2026 të afatit të dorëzimit të kundërpërgjigjes së tij ndaj Përgjigjes.¹⁴

⁷ KSC-CA-2024-03/F00069, Aktgjykimi i Apelit, 14 korrik 2025, para. 938.

⁸ Aktgjykimi i Apelit, para. 938.

⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 938.

¹⁰ Aktgjykimi i Apelit, para. 938.

¹¹ KSC-CA-2024-03/F00073, Vendim mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim, 29 janar 2026 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë (KSC-CA-2024-03/F00073/RED).

¹² PL002/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 1 maj 2026.

¹³ PL002/F00005, Përgjigje e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Urdhrit për Zhdëmtim me Shtojcën Publike 1, 26 maj 2026.

¹⁴ PL002/F00007, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit, 28 maj 2026.

9. Më 10 qershor 2026, z. Shala dorëzoi Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Vendimit mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim ("Kundërpërgjigja").¹⁵

II. PRANUESHMËRIA

10. Paneli vëren se kjo është kërkesa e parë për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar në lidhje me një urdhër për zhdëmtim. Ndryshe nga kërkesat e mëparshme për mbrojtje të ligjshmërisë, vendimi mbi të cilin bazohet Kërkesa, konkretisht Urdhri për Zhdëmtim, ndonëse i lëshuar gjatë një procesi penal në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, është i natyrës civile. Megjithatë, Paneli vëren se në nenin 48(6) të Ligjit nuk bëhet dallim midis vendimeve të natyrës penale dhe atyre të natyrës civile. Në nenin 48(6) të Ligjit kërkohet vetëm që vendimi bazë të jetë i formës së prerë.

11. Paneli vë në dukje se me lëshimin e Vendimit mbi Apelin, Urdhri për Zhdëmtim bëhet i formës së prerë në kuptim të nenit 48(6) të Ligjit. Paneli gjithashtu vëren se Kërkesa është dorëzuar brenda tre muajsh nga lëshimi i Vendimit mbi Apelin sikurse kërkohet në bazë të nenit 48(6) të Ligjit dhe rregullës 193(1) të Rregullores. Rrjedhimisht, Kërkesa është e pranueshme në këtë aspekt.

III. STANDARDI I SHQYRTIMIT

12. Paneli rikujton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të cilësohet si apel në shkallë të tretë,¹⁶ dhe në të nuk ngrihen aspekte sipas nenit 48(1) – (5) të Ligjit. Ajo është mjet juridik i jashtëzakonshëm i parashikuar në nenin 48(6) dhe (7) të Ligjit dhe në rregullat 193 dhe 194 të Rregullores. Synimi me të nuk është që të krijohet një

¹⁵ PL002/F00008, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Vendimit mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim, 10 qershor 2026.

¹⁶ Shih nenin 47 të Ligjit.

mundësi tjetër për apel.¹⁷ Përkundrazi, dhe ngjashëm me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës,¹⁸ kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bëhet vetëm për raste specifike të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore. Sikurse ka theksuar Gjykata Supreme e Kosovës:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një ndër mjetet e jashtëzakonshme ligjore, është mjeti përjashtimor ligjor që synon të korrigjojë mundësisht zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Kërkesat e rrepta të pranueshmërisë synojnë të sigurojnë që ky mjet ligjor të mos përdoret si një shkallë e tretë e përgjithshme kundër të gjitha vendimeve në procedurën penale.¹⁹

13. Rrjedhimisht, ndaj arsyeve mbi të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen kritere të rrepta të pranueshmërisë.²⁰

14. Argumentet që logjikisht mund të ishin paraqitur para paneleve në shkallë të parë dhe të dytë, nuk mund të paraqiten *de novo* para Panelit të Gjykatës Supreme.²¹ Gjithashtu, arsyet mbi të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, me të cilat pretendohen konstatime të gabuara ose të paplota të fakteve, nuk janë në kompetencën e këtij Paneli dhe për rrjedhojë, janë të papranueshme.²² Thjesht mospajtimi me vlerësimin e fakteve nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, ose përsëritja fjalë për fjalë e parashtrimeve të bëra në apelet e mëparshme, pa trajtuar në

¹⁷ Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve., KSC-BC-2020-06/PL002/F00005, Vendim mbi Kërkesën e z. Veseli për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 19 dhjetor 2025 ("Vendimi në Çështjen Veseli"), para. 17; Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve., KSC-BC-2020-06/PL003/F00004, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit (IA035/F00005), 29 dhjetor 2025 ("Vendimi në Çështjen Krasniqi"), para. 18; Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës, KSC-SC-2024-02/F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024 ("Vendimi në Çështjen Mustafa"), para. 11; Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt, KSC-SC-2023-01/F00021, Vendim mbi Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 18 shtator 2023 ("Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinajt"), para. 9.

¹⁸ Shih nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 08/L-032, Gazeta Zyrtare nr. 24, 17 gusht 2022.

¹⁹ Gjykata Supreme e Kosovës, S.S., Pml.Kzz 42/2017, Aktgjykim, 10 maj 2017, para. 23; Vendimi në Çështjen Veseli, para. 17; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 18.

²⁰ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 18; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 19.

²¹ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 20; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 21; Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 14; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinajt, para. 10.

²² Rregulla 193(3) e Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin në Çështjen Veseli, para. 21; Vendimin në Çështjen Krasniqi, para. 22; Vendimin në Çështjen Mustafa, para. 15; Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinajt, para. 10.

mënyrë substanciale vendimin e kundërshtuar apo aktgjykimin e formës së prerë dhe pa evidentuar gabimin apo shkeljen konkrete të pretenduar, janë po ashtu të pamjaftueshme për të përmbushur standardin pranueshmërisë së këtyre arsyeve.²³

15. Gjatë vlerësimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në varësi të llojit të shkeljes së pretenduar nga pala, Paneli përcakton nëse ka shkelje të të drejtës penale të përfshirë në Ligj ose shkelje të konsiderueshme të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.²⁴

16. Në këtë kontekst, Paneli rikujton standardin e lartë të përcaktuar në nenin 48(7)(b) të Ligjit në lidhje me shkeljet e konsiderueshme të procedurave.²⁵ Më konkretisht, Paneli vendosi se “shkelje të konsiderueshme” të procedurave kemi kur shkelja “ka ndikim juridikisht thelbësor në konstatimin gjyqësor”.²⁶ Pretendimi për shkelje të konsiderueshme të procedurave, sikurse përcaktohet në Ligj dhe Rregullore, duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat bazohet secila kërkesë.²⁷

17. Paneli i Gjykatës Supreme gjithashtu rikujton se mund të konstatojë shkelje të konsiderueshme të procedurave në qoftë se, për shembull, Paneli i Gjykatës së Apelit: (i) nuk ka zbatuar një dispozitë të Ligjit apo Rregullores; (ii) ka zbatuar në mënyrë të gabuar Ligjin dhe/ose Rregulloren; ose (iii) ka shkelur të drejtat e Mbrojtjes në një

²³ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 22; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 23; Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 16; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10; Vendimi në Çështjen Veseli, para. 25.

²⁴ Neni 48(7) i Ligjit; Vendimi në Çështjen Veseli, para. 19; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 20.

²⁵ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 23; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 24; Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 17; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14.

²⁶ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 23; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 24; Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 17; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14.

²⁷ Shih gjithashtu Shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, NV, Pml.Kzz 91/2015, Aktgjykim, 14 maj 2015, para. 4, 10-12; AM, Pml.Kzz 84/2015, Aktgjykim, 12 maj 2015, f. 3-4; M.I., Pml.Kzz 26/2015, Aktgjykim, 18 mars 2015, f. 5-7 ; Vendimi në Çështjen Veseli, para. 23; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 24.

mënyrë që ka ndikuar në dhënien e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë.²⁸

18. Paneli do të zbatojë të njëjtin standard për shkeljet e konsiderueshme të procedurave në lidhje me vendimet e formës së prerë për urdhrat e zhdëmtimit.

19. Paneli gjithashtu përcaktoi standardin e shqyrtimit që zbatohet në lidhje me shkeljen ose shkeljet e të drejtës penale të përcaktuara në nenin 48(7)(a) të Ligjit.²⁹ Paneli konstatoi se ky nen nuk kërkon që shkelja e të drejtës penale të jetë “e konsiderueshme”.³⁰

20. Paneli vëren se Urdhri për Zhdëmtim u lëshua veçmas, pas shpalljes së aktgjyqimit dhe dënimit. Megjithatë, Paneli vëren se në nenin 44 të Ligjit, nën titullin “Dënimet”, përfshihet lëshimi i urdhrit për zhdëmtim. Paneli gjithashtu vëren se në nenin 44(6) të Ligjit parashikohet mundësia që “krahas dënimit me burg” personi i dënuar mund të urdhërohet të dëmshpërblejë ose të paguajë kompensim, çka lë të kuptohet se Ligji parashikon lëshimin e një urdhri për zhdëmtim si pjesë e dënimit të përgjithshëm që i jepet personit të shpallur fajtor.³¹

21. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se, në listën shteruese të shkeljeve të të drejtës penale të parashikuara në nenin 385(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, shkelja e mëposhtme është relevante në lidhje me urdhrat për zhdëmtim: në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore të saj.³²

22. Paneli thekson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të bazohet edhe në

²⁸ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 24; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 25; Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 18; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14.

²⁹ Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 19; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

³⁰ Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 19; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

³¹ Cf. United States Supreme Court, *Ellingburg v. United States*, 607 U.S., 20 January 2026.

³² Neni 385(1)(1.1-1.6) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Shih gjithashtu Vendimin në Çështjen Mustafa, para. 20; Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

nenin 48(8) të Ligjit, ku përcaktohet se kërkesa për mjet juridik të jashtëzakonshëm mund të paraqitet edhe në bazë të të drejtave sipas këtij Ligji, të cilat gjithashtu janë të mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"). Paneli gjykon se çdo pretendim për shkelje të të drejtave sipas Ligjit, të cilat mbrohen edhe nga KEDNJ-ja, duhet të përmbushë të njëjtin standard shqyrtimi të përcaktuar më lart.³³

23. Paneli gjithashtu ka konstatuar se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të evidentojë qartë shkeljen e pretenduar të ligjit, ta fakttojë atë dhe, në rastin e shkeljes së procedurave, të tregojë se si ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin apo aktvendimin e kundërshtuar.³⁴

24. Së fundi, Paneli rikujton rregullën 194(1) të Rregullores, në të cilën përcaktohet se, nëse Paneli i Gjykatës Supreme miraton kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në varësi të llojit të shkeljes, paneli:

- (a) modifikon aktvendimin ose aktgjykimin e kundërshtuar;
- (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kundërshtuar dhe ia kthen çështjen për vendim të ri ose rigjykim panelit kompetent;
- (c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore.

IV. DISKUTIM

A. GABIM NË STANDARDIN E ZBATUESHËM TË SHQYRTIMIT (PIKA 1)

1. Parashtrimet

25. Z. Shala parashtron se Paneli i Apelit shkeli nenet 3(2) dhe 21 të Ligjit, rregullën 5 të Rregullores dhe nenin 6 të KEDNJ-së kur nuk zbatoi standardin e saktë të shqyrtimit në procedurën e zhdëmtimit në apel dhe, rrjedhimisht, shkeli të drejtën e

³³ Shih Vendimin në Çështjen Veseli, para. 25; Vendimin në Çështjen Krasniqi, para. 26; Vendimin në Çështjen Mustafa, para. 21; Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 18.

³⁴ Vendimi në Çështjen Veseli, para. 26; Vendimi në Çështjen Krasniqi, para. 27; Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 22; Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 19. Shih gjithashtu Vendimin në Çështjen Veseli, para. 37-38, 58, 70-71, 76, dhe Vendimin në Çështjen Krasniqi, para. 42-43, 49-50, 60, ku Paneli zbatoi këtë standard duke konstatuar se Mbrojtja nuk evidentoi shkelje konkrete ligjore apo procedurale, nuk paraqiti mospajtime në lidhje me faktet dhe nuk paraqiti ndonjë material që ndikoi në vendimin e kundërshtuar.

z. Shala për “qasje efektive në gjykatë dhe të drejtën për apel”.³⁵ Konkretisht, z. Shala pretendon se ekziston një zbraçeti ligjor në Ligj lidhur me standardin e shqyrtimit në procedurën e zhdëmtimit në apel dhe se Paneli i Apelit nuk zbatoi rregullën 5 të Rregullores.³⁶ Sipas z. Shala, në vend të kësaj, Paneli i Apelit “bëri një interpretim të gjerë të nenit 46 të Ligjit [të tillë që] çoi në një vendim të qartë arbitrar dhe rezultoi në shkelje të procesit ligjor të rregullt dhe drejtësisë themelore të procesit, në veçanti, të parimit të sigurisë juridike”.³⁷ Z. Shala argumenton se gabimi procedural përbën shkelje të konsiderueshme të procedurave dhe Paneli i Gjykatës Supreme duhet të anulojë Vendimin mbi Apelin e Mbrojtjes dhe “t’ia kthejë çështjen për vendim të ri një paneli kompetent”.³⁸

26. Z. Shala argumenton se mungesa e qartësisë në lidhje me standardin e shqyrtimit që zbatohet në procedurën e zhdëmtimit, shkeli gjithashtu “parimet procedurale” si “siguria juridike, drejtësia dhe efektiviteti i mjeteve juridike”, çka i pamundësoi atij “të përshtaste në mënyrë efektive parashtrimet e veta për t’u siguruar se përmbushej standardi i duhur”.³⁹ Në lidhje me këtë, z. Shala pretendon se standardi paarsyeshmërisht i lartë i zbatuar prej Panelit të Apelit çoi në hedhjen poshtë në mënyrë të gabuar të disa prej argumenteve të tij.⁴⁰

27. Sipas z. Shala, Paneli i Apelit duhet të kishte zbatuar standardin e shqyrtimit të përdorur nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (“GJPN”), konkretisht:

“Dhoma e Apelit nuk i jep përparësi interpretimit të ligjit të bërë prej Dhomës Gjyqësore. Përkundrazi, ajo nxjerr përfundimet e veta lidhur me dispozitat ligjore të përshtatshme për t’u zbatuar dhe përcakton nëse Dhoma Gjyqësore i ka keqinterpretuar ato. Në qoftë se rezultoi se Dhoma Gjyqësore ka bërë një gabim të tillë, Dhoma e Apelit ndërhyr vetëm në qoftë se gabimi ka ndikuar në masë të konsiderueshme në Vendimin e Apeluar. Një Vendim i Apeluar është ‘i ndikuar në masë të konsiderueshme nga gabimi ligjor’ në qoftë se Dhoma Gjyqësore ‘do të kishte dhënë një vendim shumë të ndryshëm nga vendimi i ndikuar prej gabimit, në qoftë se

³⁵ Kërkesa, para. 7. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 11; Kundërpërgjigjja, para. 7.

³⁶ Kërkesa, para. 9.

³⁷ Kërkesa, para. 9. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 10; Kundërpërgjigjen, para. 3-6.

³⁸ Kërkesa, para. 17.

³⁹ Kërkesa, para. 11.

⁴⁰ Kërkesa, para. 12.

nuk do ta kishte bërë gabimin.⁴¹

28. Në lidhje me gabimet faktike, z. Shala parashtroi se Paneli i Apelit duhet të kishte përdorur standardin e GJPN-së, që përcakton se “nuk do të ndërhyjë në konstatimet faktike të dhomës së shkallës së parë, përveç nëse demonstrohet se ajo ka kryer gabim të qartë, konkretisht, ka vlerësuar në mënyrë të gabuar faktet, ka marrë parasysh fakte jorelevante ose nuk ka marrë parasysh fakte relevante”.⁴²

29. Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se kjo është hera e parë që z. Shala shprehet se është shkelur rregulla 5 e Rregullores dhe pretendon se neni 46 i Ligjit ofron standardin relevant, i cili zbatohet njësoj në procedurat e zhdëmtimit.⁴³ Sipas Mbrojtjes së Viktimave, në nenin 46 të Ligjit përdoret termi “aktgjykim” ku përfshihet Urdhri për Zhdëmtim, i cili përfshihet edhe në rregullën 173(2) të Rregullores.⁴⁴ Mbrojtja e Viktimave argumenton se, për rrjedhojë, Paneli i Apelit nuk “shpërfilli” formulimin e drejtpërdrejtë të nenit 46 të Ligjit.⁴⁵ Mbrojtja e Viktimave parashtroi se z. Shala gjithashtu nuk provoi se si qasja e Panelit të Apelit pati ndikim thelbësor në Vendimin e Kundërshtuar.⁴⁶

30. Z. Shala kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Viktimave “shpërfill thelbin e argumentit të Mbrojtjes” dhe rithekson se Paneli i Apelit duhet të kishte bërë një analizë në përputhje me rregullën 5 të Rregullores, duke pasur parasysh se në Ligj nuk

⁴¹ Kërkesa, para. 13, ku citohet ICC, *The Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-3466-Red, Public Redacted Judgment on the Appeals against Trial Chamber II's 'Decision Setting the Size of the Reparations Aëard for ëhich Thomas Lubanga Dyilo is Liable', 18 July 2019 (“*Lubanga Appeal Judgment on Reparations*”), para. 28; ICC, *The Prosecutor v. Germain Katanga*, ICC-01/04-01/07-3778-Red, Public redacted Judgment on the Appeals against the Order of Trial Chamber II of 24 March 2017 entitled “Order for Reparations pursuant to Article 75 of the Statute”, 9 March 2018 (“*Katanga Appeal Judgment on Reparations*”), para. 39.

⁴² Kërkesa, para. 14, ku citohet *Lubanga Appeal Judgment on Reparations*, para. 30; ICC, *The Prosecutor v. Mathieu Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-02/12-271-Corr, Judgment on the Prosecutor's appeal against the Decision of Trial Chamber II entitled “Judgment pursuant to article 74 of the Statute”, 7 April 2015, para. 22; *Katanga Appeal Judgment on Reparations*, para. 41. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 15.

⁴³ Përgjigjja, para. 24-25. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 32-35.

⁴⁴ Përgjigjja, para. 31. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 37-39.

⁴⁵ Përgjigjja, para. 30.

⁴⁶ Përgjigjja, para. 36. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 41-42.

përcaktohet shprehimisht standardi i shqyrtimit për procedurat e zhdëmtimit.⁴⁷

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

31. Paneli mban parasysh pretendimin e z. Shala për shkelje të konsiderueshme të procedurave dhe i referohet neneve 3(2) dhe 21 të Ligjit, rregullës 5 të Rregullores dhe nenit 6 të KEDNJ-së.⁴⁸ Me fjalë të tjera, z. Shala u referohet në përgjithësi dispozitave që ai konsideron se janë shkelur, si dhe nenit përkatës të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se kjo pikë është e pranueshme dhe do të vijojë me shqyrtimin e themelësisë së saj.

32. Paneli vëren se Paneli i Apelit përcaktoi se standardi i shqyrtimit për procedurën e apelit i përfshirë në nenin 46 të Ligjit, zbatohet edhe për apelet kundër urdhrave për zhdëmtim.⁴⁹ Paneli i Apelit arriti në përfundimin se ndonëse në Ligj apo në Rregullore nuk thuhet shprehimisht asgjë në lidhje me standardin e shqyrtimit që zbatohet për apelet kundër urdhrave për zhdëmtim, neni 46 i Ligjit dhe jurisprudenca e zhvilluar më tej prej Panelit të Apelit zbatohen edhe për vendimet në lidhje me zhdëmtimet.⁵⁰ Pasi shqyrtoi me kujdes parashtrimet e z. Shala, Paneli nuk bindet nga argumenti i z. Shala se Paneli i Apelit gaboi në këtë aspekt.

33. Paneli rikujton se sipas nenit 46(9) të Ligjit dhe rregullës 173(2) të Rregullores, Gjykata e Apelit mund të dëgjojë ankesat e Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me një urdhër zhdëmtimi. Nga kjo rrjedh se Paneli i Apelit mund të dëgjojë edhe ankesat e personit të shpallur fajtor ndaj një urdhri për zhdëmtim dhe se, duke pasur parasysh përfshirjen e tij në nenin 46 të Ligjit, standardi i shqyrtimit për apelet i përcaktuar në këtë nen si dhe jurisprudenca e zhvilluar më tej prej Panelit të Apelit zbatohen njësoj edhe për urdhrat për zhdëmtim. Rrjedhimisht, sipas Panelit, nuk ka zbrazëti ligjore në Ligj apo në Rregullore, dhe Paneli i Apelit ka zbatuar saktë standardin e shqyrtimit

⁴⁷ Kundërpërgjigjja, para. 5. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 6.

⁴⁸ Shih Kërkesën, para. 7.

⁴⁹ Vendimi mbi Apelin, para. 30.

⁵⁰ Vendimi mbi Apelin, para. 28. Shih gjithashtu Vendimin mbi Apelin, para. 30.

të përcaktuar në nenin 46 të Ligjit gjatë shqyrtimit prej tij të apelit kundër Urdhrit për Zhdëmtim.

34. Siç vuri në dukje Paneli i Apelit, Dhomat e Specializuara gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me, ndër të tjera, Ligjin si *lex specialis*.⁵¹ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se, për të përcaktuar standardin e shqyrtimit, Paneli i Apelit mbajti parasysh saktë kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara dhe nuk qe i detyruar të zbatonte standardin e një gjykate apo tribunali tjetër. Me fjalë të tjera, Paneli konstaton se z. Shala, nuk mund të mbështetet në standardin e zbatuar në një gjykatë tjetër, i cili nuk është detyres për Dhomat e Specializuara, për të pretenduar për shkelje të konsiderueshme të procedurave në Dhomat e Specializuara.

35. Sidoqoftë, sikurse vuri në dukje Paneli i Apelit, Dhoma e Apelit e GJPN-së, standardi i shqyrtimit të së cilës, siç argumenton z. Shala, duhej të ishte zbatuar në lidhje me urdhrat për zhdëmtim, “zbaton të njëjtin standard shqyrtimi për gabimet ligjore dhe gabimet faktike si në lidhje me apelet kundër themelësisë së vendimeve, ashtu dhe në lidhje me apelet kundër zhdëmtimeve”.⁵² Me fjalë të tjera, Dhoma e Apelit e GJPN-së nuk zbaton një standard të ndryshëm apo më pak rigoroz shqyrtimi për apelet kundër urdhrave për zhdëmtim krahasuar me apelet kundër aktgjykimeve.

36. Gjithashtu, Paneli vëren se z. Shala nuk shpjegon se si standardi i shqyrtimit për apelet kundër urdhrave për zhdëmtim në Dhomat e Specializuara dhe ai në GJPN janë thelbësisht të ndryshëm, përveç formulimit, nëse mund të flitet për ndryshime. Siç u theksua më lart, Dhoma e Apelit e GJPN-së në mënyrë të ngjashme nuk bëri dallim midis aktgjykimeve dhe urdhrave për zhdëmtim sa i përket përdorimit të standardit të shqyrtimit.

37. Çka është me rëndësi, ashtu si Dhoma e Apelit e GJPN-së, Paneli i Apelit theksoi se Trupi Gjykses zbatoi standardin e “tërësisë së gjasave” kur bëhet fjalë për

⁵¹ Vendimi mbi Apelin, para. 29, 38. Shih gjithashtu nenin 3(2)(b) të Ligjit.

⁵² Vendimi mbi Apelin, para. 29.

standardin e vërtetimit, dhe vuri në dukje se do të mbante parasysh po këtë standard në çështjen aktuale.⁵³ Së fundi, Paneli vëren se z. Shala nuk provon se si zbatimi i standardit të shqyrtimit të GJPN-së pati ndikim thelbësor në Vendimin mbi Apelin.⁵⁴

38. Duke marrë parasysh sa më sipër, Paneli konstaton se z. Shala nuk provon se Paneli i Apelit gaboi në përdorimin e standardit të shqyrtimit të përcaktuar në nenin 46 të Ligjit gjatë shqyrtimit prej tij të Urdhrit për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 1.

B. SHKELJE E PROCESIT LIGJOR TË RREGULLT (PIKA 2)

1. Parashtrimet

39. Z. Shala pretendon se Trupi Gjykes kreu shkelje të konsiderueshme të procedurave kur zhvilloi procedura të veçanta zhdëmtimi përpara se verdiktet për fajësinë penale të tij të merrnin formë të prerë në shkallën e apelit. Sipas z. Shala, kjo shkelje të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm si dhe të drejtën e tij për "gjykim të drejtë në lidhje me të gjitha aspektet që lindin nga procedurat penale".⁵⁵ Z. Shala argumenton se këto shkelje cenuan të drejtat e tij të mbrojtura nga neni 31 i Kushtetutës së Kosovës, neni 21(2) i Ligjit dhe neni 6 i KEDNJ-së.⁵⁶ Z. Shala pretendon se Vendimi mbi Apelin duhet të anulohet dhe çështja t'i kthehet një paneli kompetent për një vendimi të ri.⁵⁷

40. Z. Shala parashtrohet se "është logjike që procesi i zhdëmtimit të pasojë procesin e apelit të konstatimeve faktike mbi të cilat bazohet verdikti i fajësisë" dhe se kjo "prirje" është e dukshme në GJPN, ku procedura e zhdëmtimit fillohet pasi verdiktet e fajësisë të kenë marrë formë të prerë.⁵⁸ Z. Shala pretendon se Trupi Gjykes i përdori

⁵³ Vendimi mbi Apelin, para. 35.

⁵⁴ Kërkesa, para. 7-17.

⁵⁵ Kërkesa, para. 18.

⁵⁶ Kërkesa, para. 18. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 20.

⁵⁷ Kërkesa, para. 26.

⁵⁸ Kërkesa, para. 19.

konstatimet faktike të veta në aktgjykim për të mbështetur disa prej urdhrave në lidhje me zhdëmtimet; konstatime këto të cilat më pas u prapësuan prej Panelit të Apelit kur fjala është për torturën dhe ndalimin arbitrar.⁵⁹ Z. Shala argumenton se në qoftë se pesha e krimeve për të cilat ai u shpall fajtor është relevante si konstatim kontekstual për të kuptuar shkallën e dëmit, sikurse u shpreh Trupi Gjykses, atëherë prapësimi i disa konstatimeve duhet të konsiderohet po aq relevant në kuptim të përgjegjësisë së z. Shala për zhdëmtimet.⁶⁰

41. Z. Shala gjithashtu argumenton se e drejta e apelit duhet të mbulojë të gjitha pasojat ligjore dhe se me lëshimin e urdhrit për zhdëmtim përpara se të gjitha konstatimet ligjore dhe faktike të merrnin formë të prerë, atij iu hoq mundësia “për të kundërshtuar plotësisht bazën e formës së prerë të përgjegjësisë”.⁶¹ Ndonëse z. Shala pranon se e pati mundësinë të parashtronte apel kundër Urdhrit për Zhdëmtim, ai pretendon se nuk pati asnjëherë mundësinë të kundërshtonte zhdëmtimet duke pasur parasysh Aktgjykimin e Apelit dhe konstatimet e përfshira në të, që ndikojnë në shkallën e përgjegjësisë së tij për zhdëmtimet.⁶² Z. Shala argumenton se dëmi që ai pësoi si rezultat u bë edhe më i madh me vendimin e Panelit të Apelit për të mos shqyrtuar parashtrimet e ngritura për herë të parë në apel.⁶³

42. Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se mënyra se si u zhvillua procedura e zhdëmtimit nuk solli ndikim negativ në drejtësinë e procesit.⁶⁴ Konkretisht, Mbrojtja e Viktimave argumenton se të gjitha konstatimet faktike në të cilat u mbështet Trupi Gjykses për Urdhrin për Zhdëmtim, u konfirmuan prej Panelit të Apelit.⁶⁵ Rrjedhimisht, sipas Mbrojtjes së Viktimave, z. Shala nuk provon se si radha e hapave

⁵⁹ Kërkesa, para. 20-21.

⁶⁰ Kërkesa, para. 21; Kundërpërgjigjja, para. 9.

⁶¹ Kërkesa, para. 22.

⁶² Kërkesa, para. 23; Kundërpërgjigjja, para. 10.

⁶³ Kërkesa, para. 24. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 25.

⁶⁴ Përgjigjja, para. 47. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 44-46.

⁶⁵ Përgjigjja, para. 47.

proceduralë pati ndikim thelbësor në Vendimin e Kundërshtuar.⁶⁶

43. Z. Shala kundërpërgjigjet se drejtësia e procesit duhej të vlerësohej në kohën kur u lëshua Urdhri për Zhdëmtim dhe “jo retrospektivisht pasi kishte përfunduar shqyrtimi i apelit në lidhje me themelësinë” dhe se në Aktgjykimin e Apelit u konfirmuan “disa konstatime”.⁶⁷

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

44. Paneli mban parasysh argumentin e z. Shala për shkelje të konsiderueshme të procedurave dhe i referohet nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 21(2) të Ligjit dhe nenit 6 të KEDNJ-së.⁶⁸ Me fjalë të tjera, z. Shala u referohet dispozitave që ai konsideron se janë shkelur, si dhe nenit përkatës të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se kjo pikë është e pranueshme dhe do të vijojë me shqyrtimin e themelësisë së saj.

45. Paneli rikujton se kur pretendohet për shkelje të konsiderueshme të procedurave, duhet gjithashtu të provohet se si kjo shkelje pati ndikim thelbësor në Vendimin e Kundërshtuar.⁶⁹

46. Paneli thekson se Paneli i Apelit arriti në përfundimin se konstatimet e bëra në Aktgjykimin e Apelit “nuk k[ishin] të bënin me krimet e kryera kundër V01/04-ës apo W04733-shit, dhe, rrjedhimisht, nuk ndikojnë në krimet që mund të përbëjnë bazën e lidhjes shkakësore midis krimit ose krimeve dhe dëmit ose dëmeve të pretenduara të pësuar nga viktimat në kuadër të zhdëmtimeve”.⁷⁰ Paneli i Apelit gjithashtu vuri në dukje se la në fuqi verdiktet e tjera të fajësisë së z. Shala për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme.⁷¹ Paneli i Apelit theksoi se z. Shala pati

⁶⁶ Përgjigja, para. 47.

⁶⁷ Kundërpërgjigja, para. 8.

⁶⁸ Shih Kërkesën, para. 18.

⁶⁹ Shih më lart, para. 16.

⁷⁰ Vendimi mbi Apelin, para. 70.

⁷¹ Vendimi mbi Apelin, para. 70.

mundësi të apelonte Urdhrin për Zhdëmtim, konstatoi se, për rrjedhojë, ai nuk qe dëmtuar dhe hodhi poshtë pretendimin e z. Shala se Urdhri për Zhdëmtim duhej të ishte lëshuar pas shpalljes së Aktgjykimit të Apelit.⁷²

47. Paneli vëren se as Ligji dhe as Rregullorja nuk përjashtojnë lëshimin e urdhrit për zhdëmtim para shpalljes së aktgjykimit të apelit. Në fakt, në nenin 22(8) të Ligjit përcaktohet se Trupi Gjykses ose Paneli i Apelit mund të lëshojnë urdhër ndaj të akuzuarit ku specifikohet zhdëmtimi i përshtatshëm. Personi i shpallur fajtor ndaj të cilit lëshohet urdhri për zhdëmtim, mund ta apelojë urdhrin. Në mënyrë të ngjashme, paneli i apelit, siç ka bërë dhe Paneli i Apelit në këtë çështje, mund të reflektojë mbi konstatimet e bëra në Aktgjykimin e Apelit dhe të përcaktojë nëse ndonjë prej këtyre konstatimeve ndikon në Urdhrin për Zhdëmtim të lëshuar para Aktgjykimit të Apelit. Në fakt, Paneli i Apelit i shqyrtoi konstatimet e bëra në Aktgjykimin e Apelit dhe arriti në përfundimin se ato nuk ndikonin në përgjegjësinë civile të z. Shala brenda kontekstit të Urdhrit për Zhdëmtim.⁷³

48. Gjithashtu, Paneli i Apelit nuk “vendosi të mos shqyrtonte parashtrime të ngritura për herë të parë në apel”, sikurse sugjeron z. Shala.⁷⁴ Paragrafët të cilëve u referohet z. Shala në mbështetje të këtij pretendimi janë pjesë e standardit të shqyrtimit për apelet të Panelit të Apelit. Ky standard nuk e pengon z. Shala që të ngrejë aspekte para Panelit të Apelit, përveç kur z. Shala mund t’i kishte ngritur ato në mënyrë të arsyeshme para Trupit Gjykses, dhe nuk e bëri këtë. Argumentet e hedhura poshtë prej Panelit të Apelit pa shqyrtuar themelësinë të cilës i referohet z. Shala për të faktuar dëmin e pretenduar të shkaktuar atij, ishin në fakt argumente për të cilat Paneli i Apelit gjykoi se mund të ishin ngritur në mënyrë të arsyeshme para Trupit Gjykses dhe nuk u ngritën.⁷⁵ Me fjalë të tjera, hedhja poshtë prej Panelit të Apelit e

⁷² Vendimi mbi Apelin, para. 71.

⁷³ Shih Vendimin mbi Apelin, para. 70.

⁷⁴ Kërkesa, para. 24, që i referohet Vendimit mbi Apelin, para. 42-44.

⁷⁵ Shih Kërkesën, para. 24, që i referohet Vendimit mbi Apelin, para. 135, 146 dhe poshtëshënimit 386.

argumenteve të z. Shala nuk ishte rezultat i radhës së shpalljes dhe lëshimit, përkatësisht, të Aktgjykimit të Apelit dhe Urdhrit për Zhdëmtim, por rezultat i mosngritjes prej z. Shala të këtyre argumenteve në procesin gjyqësor para Trupit Gjyqësor kur mund ta kishte bërë këtë në mënyrë të arsyeshme.

49. Paneli vëren se z. Shala nuk citon jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të faktuar argumentin e tij se është shkelur neni 6 i KEDNJ-së.⁷⁶ Në vend të kësaj, z. Shala i referohet “një prirjeje e dukshme” në GJPN, përmes së cilës duket se sugjeron se në Dhomat e Specializuara ka ndodhur një shkelje.⁷⁷ Paneli konstaton se z. Shala nuk mund të mbështetet në pretendimin për këtë “prirje të dukshme” në një gjykatë tjetër, që nuk ka fuqi detyruese mbi Dhomat e Specializuara, për të ngritur pretendimin për shkelje të konsiderueshme të procedurave në Dhomat e Specializuara.

50. Sidoqoftë, Paneli vëren se, në mënyrë të ngjashme, në GJPN lëshimi i urdhrit për zhdëmtim nuk bëhet pas shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë në çështjen përkatëse.⁷⁸ Në rregullat 143 dhe 144 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të GJPN-së, ku flitet për Dhomën Gjyqësore në kontekstin e seancave në lidhje me zhdëmtimin dhe shpalljen e aktgjykimit, përfshirë përcaktimin e dënimit dhe zhdëmtimet, lihet të kuptohet se këto procedura përgjithësisht zhvillohen para një Dhome Gjyqësore. Si dhe në Dhomat e Specializuara, apeli kundër një urdhri për zhdëmtim të lëshuar prej Dhomës Gjyqësore, mund t’i parashtrohet Dhomës së Apelit të GJPN-së.⁷⁹

51. Ndonëse disa urdhra për zhdëmtim në GJPN faktikisht janë lëshuar pasi

⁷⁶ Shih Kërkesën, para. 18-26.

⁷⁷ Kërkesa, para. 19.

⁷⁸ Shih GJPN, nenin 75 të Statutit të Romës, ku përgjithësisht thuhet ‘Gjykata’ dhe nuk bëhet dallim midis Dhomës Gjyqësore dhe Dhomës së Apelit.

⁷⁹ Shih rregullën 150 të Rregullores së GJPN-së.

aktgjykimi ka marrë formë të prerë, siç argumenton z. Shala,⁸⁰ urdhra të tjerë për zhdëmtim janë lëshuar para shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë në çështjen përkatëse.⁸¹ Rrjedhimisht, në GJPN nuk ka një praktikë të përcaktuar dhe korniza normative e saj, si ajo e Dhomave të Specializuara, nuk pengon lëshimin e urdhrave për zhdëmtim para se aktgjykimi të marrë formë të prerë. Me fjalë të tjera, për sa kohë që personi i shpallur fajtor mund të apelojë urdhrin për zhdëmtim, atij nuk i shkaktohet asnjë dëm.

52. Rrjedhimisht, Paneli nuk gjykon se Paneli i Apelit gaboi në këtë aspekt, as se z. Shala u dëmtua nga radha e shpalljes dhe lëshimit të, përkatësisht, Aktgjykimit të Apelit dhe Urdhrit për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 2.

C. GABIM NË PARIMIN E SHKAKËSISË (PIKA 3)

1. Parashtrimet

53. Z. Shala parashtron se Trupi Gjykses kreu shkelje të konsiderueshme të procedurave me përmendjen e “krimit dhe dëmit” në vend të “sjelljes së fajshme dhe dëmit”, si pikënisje për standardin e parimit të shkakësisë dhe si rezultat i mosvlerësimit të shkallës së lidhjes midis sjelljes së z. Shala dhe dëmit të pësuar nga viktimat.⁸² Sipas z. Shala, këto mangësi në vlerësim shkelën të drejtën e tij për gjykim të drejtë të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës së Kosovës, neni 21(2) i Ligjit dhe neni 6 i KEDNJ-së.⁸³ Z. Shala argumenton se Vendimi mbi Apelin duhet të anulohet dhe

⁸⁰ Shih Kërkesën, para. 19, ku citohet ICC, *Katanga Appeal Judgment on Reparations*; ICC, *The Prosecutor v. Ahmad Al Faqi Al Mahdi*, Case No. ICC- 01/12-01/15, Reparations Order, 17 August 2017; ICC, *The Prosecutor v. Dominic Ongwen*, Case No. ICC-02/04- 01/15, Reparations Order, 28 February 2024 (“*Ongwen Reparations Order*”).

⁸¹ Cf. ICC, *The Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo*, Case No. ICC-01/04-01/06 A A 2 A 3, Judgment on the Appeals against the “Decision Establishing the Principles and Procedures to be Applied to Reparations” of 7 August 2012 with AMENDED Order for Reparations (Annex A) and Public Annexes 1 and 2, 3 March 2015 (“*Lubanga Appeal Judgment on Principles of Reparations*”); *The Prosecutor v. Bosco Ntaganda*, Case No. ICC-01/04-02/06 A4-A5, Judgment on the Appeals against the Decision of Trial Chamber VI of 8 March 2021 entitled “Reparations Order”, 12 September 2022 (“*Ntaganda Reparations Judgment*”).

⁸² Kërkesa, para. 27.

⁸³ Kërkesa, para. 27.

çështja t'i kthehet një paneli kompetent për një vendim të ri.⁸⁴

54. Z. Shala parashtron se Trupi Gjykses gaboi që gjykoi se Shala ishte përgjegjës për kompensimin e dëmit që nuk u shkaktua nga veprimet apo mosveprimet e tij, por nga "krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor".⁸⁵ Z. Shala gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses përcaktoi saktë se duhet të ekzistojë lidhja shkakësore, por më pas zbatoi në mënyrë të gabuar standardin "sikur të mos ishte" midis krimit dhe dëmit.⁸⁶ Z. Shala argumenton se Paneli i Apelit arriti në përfundimin e gabuar se kuptimi i zakonshëm i nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores kërkon vërtetimin e lidhjes midis krimit dhe dëmit, veçanërisht duke pasur parasysh kontekstin ligjor në të cilin akordohen zhvendimet në Dhomat e Specializuara.⁸⁷ Sipas z. Shala, ky standard çon në një "vlerësim që përqendrohet në rezultat, duke ngatërruar kështu dallimin midis ngjarjes penale dhe përgjegjësisë që mund të atribuohet".⁸⁸

55. Mbrojtja e Viktimave parashtron se argumentet e z. Shala në lidhje me shkakësinë në procedurat e zhvendimit u trajtuan në mënyrë të plotë nga të dy panelet dhe z. Shala thjesht përsërit argumente, pa dhënë ndonjë burim ligjor apo mbështetje të mëtijshme për to.⁸⁹

56. Z. Shala kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Viktimave nuk shpjegon "pse vërtetimi i lidhje shkakësore duhet të fillojë dhe të mbarojë me ekzistencën e vetë krimit dhe jo me sjelljen që i atribuohet z. Shala".⁹⁰

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

57. Paneli mban parasysh pretendimin e z. Shala për shkelje të konsiderueshme të procedurave dhe i referohet nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 21(2) të Ligjit

⁸⁴ Kërkesa, para. 31.

⁸⁵ Kërkesa, para. 28.

⁸⁶ Kërkesa, para. 28.

⁸⁷ Kërkesa, para. 29.

⁸⁸ Kërkesa, para. 30. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 11.

⁸⁹ Përgjigja, para. 48-49. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 50-52.

⁹⁰ Kundërpërgjigja, para. 11.

dhe nenit 6 të KEDNJ-së.⁹¹ Me fjalë të tjera, z. Shala u referohet dispozitave që pretendon se janë shkelur, si dhe nenit përkatës të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se kjo pikë është e pranueshme dhe do të vijojë me shqyrtimin e themelësisë së saj.

58. Paneli i Apelit konstatoi se kuptimi i zakonshëm i nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores pasqyron se viktimat duhet të ketë pësuar dëm *si rezultat i drejtpërdrejtë* i një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.⁹² Me fjalë të tjera, Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses përcaktoi saktë se zhdëmtimet duhet të akordohen “bazuar në dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara në lidhje me të cilat personi është shpallur fajtor tashmë”.⁹³

59. Paneli i Apelit gjithashtu nuk u bind nga interpretimi prej z. Shala i mënyrës se si duhet zbatuar standardi “sikur të mos ishte”, duke shpjeguar se z. Shala iu referua në mënyrë të gabuar të drejtës së delikteve civile, dhe jo urdhrave për zhdëmtim të lëshuar në kontekstin e proceseve penale, dhe duke hedhur poshtë argumentet e tjera të z. Shala në këtë aspekt.⁹⁴

60. Paneli rikujton se një person që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të ofrojë argumente dhe mbështetje për këtë.⁹⁵ Paneli vëren se z. Shala nuk paraqet mbështetje, arsye të mëtejshme apo ndonjë bazë për argumentin e tij se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit gabuan në shqyrtimin prej tyre të formulimit të drejtpërdrejtë të nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores,⁹⁶ dhe as citon ndonjë jurisprudencë në mbështetje të interpretimit të vet. Në mënyrë të ngjashme, z. Shala nuk përmend asnjë fakt në

⁹¹ Shih Kërkesën, para. 27.

⁹² Vendimi mbi Apelin, para. 90, ku citohet *Lubanga Appeal Judgment on Principles of Reparations*, para. 79.

⁹³ Vendimi mbi Apelin, para. 90, ku citohet *Lubanga Appeal Judgment on Principles of Reparations*, para. 79.

⁹⁴ Vendimi mbi Apelin, para. 92.

⁹⁵ Shih më lart, para. 14.

⁹⁶ Shih Kërkesën, para. 27-31.

mbështetje të pretendimit të vet se panelet gabuan në mënyrën se si zbatuan standardin “sikur të mos ishte”,⁹⁷ i cili zbatohet në mënyrë të ngjashme në GJPN.⁹⁸ Z. Shala thjesht nuk pajtohet me interpretimin e dhënë prej Trupit Gjykses dhe Panelit të Apelit, pa faktuar argumentet e veta.

61. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se z. Shala nuk tregoi se ishte kryer shkelje e konsiderueshme e procedurave prej Trupit Gjykses dhe Panelit të Apelit në interpretimin prej tyre të nenit 22(1) të Ligjit, rregullës 2 të Rregullores dhe në zbatimin prej tyre të standardit “sikur të mos ishte” gjatë përcaktimit të zhdëmtimeve që do t’u akordoheshin viktimave. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 3 në tërësi.

D. GABIM NË AKORDIMIN E SHPENZIMEVE MJEKËSORE (PIKA 4)

1. Parashtrimet

62. Z. Shala argumenton se Trupi Gjykses shkeli konsiderueshëm procedurën kur, gjatë përcaktimit të shumës së zhdëmtimit për dëmin material që pësuan disa prej familjarëve të W04733-shit, të cilët u pranuan si viktimë të tërthorta, nuk kërkoi dorëzimin e të dhënave për shpenzimet mjekësore të W04733-shit.⁹⁹ Sipas Shalës, gabimi i Trupit Gjykses rezultoi në “keqinterpretim dhe zbatim të gabuar të nenit 22 të Ligjit dhe rregullës 168 të Rregullores [, që] kërkojnë ‘zhdëmtime të përshtatshme’”.¹⁰⁰ Z. Shala parashtron se Vendimi mbi Apelin duhet të anulohet dhe çështja t’i kthehet një paneli kompetent për një vendim të ri.¹⁰¹

63. Z. Shala pretendon se Trupi Gjykses gaboi që “mori përsipër” të përcaktonte ‘shpenzimet mjekësore ose për lloje të tjera të dëmit financiar ose pasuror’ dhe kur konstatoi se nuk ishte “kusht që të dorëzohe[shin] të dhëna për faktimin e dëmit”.¹⁰²

⁹⁷ Shih Kërkesën, para. 27-31.

⁹⁸ Shih Vendimin mbi Apelin, para. 90, ku citohet *Ongwen Reparations Order*, para. 418; *Ntaganda Reparations Judgment*, para. 131; *Lubanga Appeal Judgment on Principles of Reparations*, para. 80.

⁹⁹ Kërkesa, para. 32.

¹⁰⁰ Kërkesa, para. 32.

¹⁰¹ Kërkesa, para. 40.

¹⁰² Kërkesa, para. 33. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 35.

Z. Shala parashtron se Trupi Gjykues gjithashtu gaboi që nuk saktësoi nëse viktimat vuanin nga patologji mjekësore para ndalimit të tyre dhe masën në të cilën keqtrajtmet përkeqësuan këto patologji mjekësore.¹⁰³

64. Z. Shala argumenton se Paneli i Apelit nuk vlerësoi nëse në këtë çështje ishte përmbushur standardi i duhur i vërtetimit dhe, në vend të kësaj, konstatoi në mënyrë të gabuar se GJPN-ja zbatonte të njëjtin standard.¹⁰⁴ Z. Shala parashtron se jurisprudenca e GJPN-së në të cilën u mbështet Paneli i Apelit dallon nga ajo e çështjes aktuale, pasi çështjet gjyqësore të GJPN-së përfshinin rrethana ku nuk kishte prova dokumentare ose për viktimat që i pamundur marrja e këtij lloj dokumentacioni.¹⁰⁵ Z. Shala pretendon se viktimave në çështjen e tij nuk iu kërkuar të dorëzonin dokumente në mbështetje të pretendimeve të tyre dhe as të shpjegojnë pse nuk mund të jepnin apo të dorëzonin dokumente të tilla.¹⁰⁶

65. Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se Paneli i Apelit analizoi “në mënyrë shteruese/të plotë” konstatimet e Trupit Gjykues, përfshirë jurisprudencën përkatëse të GJPN-së.¹⁰⁷ Sipas Mbrojtjes së Viktimave, “Trupi Gjykues ishte në të drejtën e vet të pranonte dëshmitë e familjarëve të W04733-shit” dhe “shumat e zhdëmtimit të akorduara viktimave të tërthorta ishin vetëm një pjesë e humbjes që ata realisht pësuan”.¹⁰⁸

66. Z. Shala kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Viktimave nuk trajton “mangësinë kryesore të evidentuar” prej tij, konkretisht “se as Trupi Gjykues, as Paneli i Apelit nuk shpjeguan pse megjithë mungesën e mbështetjes me dokumente në këtë çështje, standardi i zbatueshëm i vërtetimit për akordimin e zhdëmtimeve për dëme materiale

¹⁰³ Kërkesa, para. 33. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 34; Kundërpërgjigjen, para. 16.

¹⁰⁴ Kërkesa, para. 36.

¹⁰⁵ Kërkesa, para. 36, *ku citohet Ongwen Reparations Order*, para. 436.

¹⁰⁶ Kërkesa, para. 36. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 37-39; Kundërpërgjigjen, para. 14.

¹⁰⁷ Përgjigjja, para. 54. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 55-57.

¹⁰⁸ Përgjigjja, para. 58.

u gjykua i përmbushur”.¹⁰⁹

67. Z. Shala kundërpërgjigjet se konstatimi i Panelit të Apelit se jurisprudenca e GJPN-së nuk “e trajton mungesën e dokumentacionit si pengesë automatike për zhdëmtimet”, nuk e liron Trupin Gjykses nga detyrimi për të vlerësuar nëse akordimi i shumave të zhdëmtimit për shpenzimet mjekësore ka mbështetje të mjaftueshme me prova duke marrë parasysh rrethanat e kësaj çështjeje.¹¹⁰ Sipas z. Shala, ndonëse Trupi Gjykses pranoi se “jo të gjitha aspektet e gjendjes së përkeqësuar shëndetësore të W04733-shit ishin të lidhura drejtpërdrejt me krimet, ai nuk dha një analizë të arsyetuar se cilat shpenzime mjekësore lidheshin shkakësisht me dëmin e konstatuar dhe mbi bazën e cilave prova u përcaktuan shumat e zhdëmtimit të akorduara”.¹¹¹

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

68. Paneli mban parasysh pretendimin e z. Shala për shkelje të konsiderueshme të procedurave dhe i referohet nenit 22 të Ligjit dhe rregullës 168 të Rregullores.¹¹² Me fjalë të tjera, z. Shala u referohet në përgjithësi dispozitave që pretendon se janë shkelur. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se kjo pikë është e pranueshme dhe do të vijojë me shqyrtimin e themelësisë së saj.

69. Pasi shqyrtoi Urdhrin për Zhdëmtim, Paneli i Apelit arriti në përfundimin se Trupi Gjykses ndoqi një metodologji “të krahasueshme” me atë të GJPN-së, që merr parasysh vështirësitë e hasura nga viktimat e krimeve ndërkombëtare për ofrimin e dokumentacionit në mbështetje të kërkesave të tyre për zhdëmtim dhe verifikimin e tyre rast pas rasti.¹¹³ Paneli vëren se në lidhje me këtë metodologji nuk ka

¹⁰⁹ Kundërpërgjigjja, para. 13.

¹¹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 15. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 17.

¹¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 16.

¹¹² Shih Kërkesën, para. 32.

¹¹³ Vendimi mbi Apelin, para. 144, ku citohet ICC, *The Prosecutor v. Dominic Ongwen*, Case No. ICC-02/04-01/15 A3, Judgment on the Appeal of Mr Dominic Ongwen against the Decision of Trial Chamber IX of 28 February 2024 entitled “Reparations Order”, 7 April 2025, paras 175-177, 183-184; *Lubanga* Appeal Judgment on Reparations, paras 202-204; *Katanga* Appeal Judgment on Reparations, para. 89.

mospajtime.¹¹⁴

70. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit mbajti parasysh konstatimin e Trupit Gjykues se “në rrethanat e kësaj çështjeje, nuk ishte kusht që të dorëzoheshin të dhëna për shpenzimet e trajtimeve mjekësore”, dhe veçanërisht atë në lidhje me kalimin e kohës.¹¹⁵

71. Paneli i Apelit gjithashtu mbajti parasysh standardin e përcaktuar nga GJPN-ja se

“një person mund të përmbushë kriteret për zhdëmtim në rrethana kur ai nuk ka dhënë arsye për pamundësinë e tij për të dorëzuar dokumentacion mbështetës. Megjithatë, ‘për t’i mundësuar dhomës gjyqësore që të nxjerrë një përfundim, është në interes të personit që nuk ka mundësi të dorëzojë dokumentacionin që të shpjegojë arsyet për këtë pamundësi’”¹¹⁶

72. Paneli vëren se Paneli i Apelit u bind me konstatimin e përgjithshëm të Trupit Gjykues se do të merrte parasysh “çdo vështirësi me të cilën mund të jenë ballafaquar viktimat gjatë mbledhjes dhe dorëzimit të informacionit – si të të dhënave mjekësore, financiare dhe të punësimit - ndër të tjera edhe për shkak të kalimit të kohës që nga kryerja e krimeve”.¹¹⁷ Siç u shpreh me të drejtë Paneli i Apelit, mungesa e dhënies së arsyeve konkrete nga viktimat e tërthorta lidhur me pamundësinë e tyre për të ofruar dokumentacion mbështetës “në vetvete nuk është pengesë për të konsideruar se personi mund t’i ketë përmbushur kushtet për zhdëmtim në këto rrethana”.¹¹⁸

73. Paneli mban parasysh se Trupi Gjykues u shpreh se nuk është kusht që viktimat pjesëmarrëse të dorëzojnë të dhëna apo prova mbështetëse në lidhje me kërkesat e tyre për zhdëmtim.¹¹⁹ Megjithatë, në një pjesë tjetër të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi

¹¹⁴ Shih, p.sh., Kundërpërgjigjen, para. 13.

¹¹⁵ Vendimi mbi Apelin, para. 143, ku citohet Urdhri për Zhdëmtim, para. 179. Shih gjithashtu Urdhrin për Zhdëmtim, para. 134, 139.

¹¹⁶ Vendimi mbi Apelin, poshtëshënimi 373, që i referohet *Lubanga Appeal Judgment on Reparations*, para. 204; *Ntaganda Reparations Judgment*, para. 514.

¹¹⁷ Vendimi mbi Apelin, para. 143, ku citohet Urdhri për Zhdëmtim, para. 89.

¹¹⁸ Vendimi mbi Apelin, poshtëshënimi 375.

¹¹⁹ Urdhri për Zhdëmtim, para. 179.

Gjykues gjithashtu u shpreh parimisht se “viktimat e pretenduara mund të paraqesin dokumentacion mbështetës, për aq sa është e mundshme, si certifikata mjekësore, receta për barna, fotografi ose dokumentacion tjetër si dëshmi të lëndimeve trupore të pësuar”.¹²⁰ Rrjedhimisht, është e qartë se Trupi Gjykues nuk shkurajoi dorëzimin prej viktimave të dokumentacionit në mbështetje të kërkesave për zhdëmtim.

74. Në fakt, Paneli gjykon se analiza e bërë prej Trupit Gjykues në lidhje me shpenzimet mjekësore të W04733-shit tregon se Trupi Gjykues shqyrtoi dhe mbajti parasysh rrethanat individuale të W04733-shit në lidhje me mungesën e dokumenteve mbështetëse dhe disponueshmërinë e provave të tjera. Konkretisht, Trupi Gjykues mbajti parasysh vështirësitë e lidhura me mbledhjen e këtij lloji informacioni mjekësor në këtë çështje duke marrë parasysh kalimin e kohës,¹²¹ argumentet e Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me W04733-shin, të cilat i mbajti parasysh po në atë masë,¹²² stigmën që lidhej me krimet objekt i të cilave u bë W04733, dhe frikën që ai përjetoi pas kthimit në shtëpi.¹²³

75. Paneli rikujton se nuk është detyrë e Gjykatës Supreme të përcaktojë nëse vërtet Trupi Gjykues kishte prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave të arrinte në një vendim në lidhje me shpenzimet mjekësore.¹²⁴ Ky përbën vlerësim faktik që nuk është brenda mandatit të Panelit të Gjykatës Supreme.¹²⁵ Sidoqoftë, Paneli vëren se për të marrë vendimin në lidhje me zhdëmtimet që do të akordoheshin për shpenzimet mjekësore të W04733-shit,¹²⁶ Trupi Gjykues mori parasysh një sërë provash të tjera dhe

¹²⁰ Urdhri për Zhdëmtim, para. 98.

¹²¹ Shih Urdhrin për Zhdëmtim, para. 89.

¹²² Urdhri për Zhdëmtim, para. 200, ku citohet Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës, KSC-BC-2020-04/F00804/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Mbrojtjes së Viktimave për Zhdëmtime në lidhje me Dëmin Fizik, Mendor dhe Material të Pësuar nga Viktimat Pjesëmarrëse në Proces, 23 gusht 2024, para. 53-54. Versioni konfidencial u dorëzua më 4 mars 2024.

¹²³ Urdhri për Zhdëmtim, para. 134. Shih gjithashtu Urdhrin për Zhdëmtim, para. 89.

¹²⁴ Shih më lart, para. 14.

¹²⁵ Shih më lart, para. 14.

¹²⁶ Shih Urdhrin për Zhdëmtim, para. 85-88, ku Trupi Gjykues përshkroi në mënyrë të përgjithshme llojin e provave që mori parasysh “gjatë vlerësimit nëse viktimat k[ishin] vërtetuar se ekziston[te] dëmi i pretenduar dhe lidhja shkakësore midis dëmit dhe krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor”.

dëshmi të dëshmitarëve të tjerë, për të cilat Trupi Gjykses konstatoi se ishin të besueshme, si dhe provat përkatëse në lidhje shifrat e llogaritura për shpenzimet mjekësore dhe faktet e konstatuara në Aktgjykim.¹²⁷ Me fjalë të tjera, në kuadër të vlerësimit të vet në lidhje me shpenzimet mjekësore të W04733-shit, Trupi Gjykses iu referua një sërë provash dhe arsyeve pse u mbështet në to.

76. Rrjedhimisht, Paneli është i mendimit se nga analiza e kryer prej Trupit Gjykses është e qartë se, për shkak të rrethanave të veçanta të kësaj çështjeje, viktimat e tërthorta nuk qenë në gjendje të dorëzonin dokumentacion konkret që mbështeste kërkesën për shpenzimet mjekësore të W04733-shit dhe se Trupi Gjykses u mbështet në një gamë të gjerë provash të tjera, mbi të cilat bazoi vendimin e vet për akordimin e shumave të zhdëmtimit për këto shpenzime mjekësore, në përputhje me metodologjinë e përdorur prej GJPN-së.

77. Rrjedhimisht, Paneli nuk bindet nga argumentet e z. Shala se Paneli i Apelit dhe Trupi Gjykses gabuan që nuk kërkuar që viktimat e tërthorta të dorëzonin dokumentacion mbështetës për shpenzimet mjekësore të W04733-shit kur morën vendimin në lidhje me kërkesën për zhdëmtim. Paneli gjithashtu nuk arrin në përfundimin se panelet e shkallëve më të ulëta nuk dhanë vendim të arsyetuar sa u përket provave në të cilat u mbështetën për të vlerësuar dhe shqyrtuar shumat e zhdëmtimeve që do të akordoheshin për shpenzimet mjekësore të W04733-shit.

78. Paneli mban parasysh se Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses, në kundërshtim me çka pretendon z. Shala, analizoi nëse lëndimet e W04733-shit u pësuan si rezultat i krimeve të kryera (dhe jo i “problemeve shëndetësore që ai kishte para ndalimit”).¹²⁸ Paneli vëren se Trupi Gjykses sqaroi se “nga viktimat nuk kërkohet që të dokumentojnë secilin lëndim të pësuar gjatë keqtrajtimit të tyre [...], me kusht që

¹²⁷ Shih Urdhrin për Zhdëmtim, para. 179, 199-200. Shih gjithashtu Urdhrin për Zhdëmtim, para. 125-130, 139, 142.

¹²⁸ Vendimi mbi Apelin, para. 147, ku citohet Urdhri për Zhdëmtim, para. 129.

dëmi të ketë rezultuar nga krimet për të cilat z. Shala është shpallur fajtor”.¹²⁹ Siç shpjegoi Paneli i Apelit, Trupi Gjykses gjithashtu pranoi se “jo të gjitha aspektet e përkeqësimit të shëndetit të W04733-shit gjatë viteve në vijim janë rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të kryera” në fabrikën e metalit në Kukës.¹³⁰ Megjithatë, Trupi Gjykses konstatoi se brutaliteti i krimeve të kryera dhe gjendja në të cilën ishte kur u kthye në shtëpi mund “të kishin vetëm efekt përkeqësues në shëndetin e W04733-shit”.¹³¹

79. Rrjedhimisht, Paneli nuk është bindur se z. Shala provoi se në rrethanat e kësaj çështjeje, ishte kryer shkelje e konsiderueshme e procedurave gjatë shqyrtimit të shumave të zhdëmtimit të akorduara për shpenzimet mjekësore.

80. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon Pikën 4.

V. VENDIM

81. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës Supreme RRËZON Kërkesën në tërësi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse

E enjte, 25 qershor 2026

Në Hagë, Holandë

¹²⁹ Urdhri për Zhdëmtim, para. 98.

¹³⁰ Vendimi mbi Apelin, para. 147, *ku citohet* Urdhri për Zhdëmtim, para. 200.

¹³¹ Vendimi mbi Apelin, para. 147, *ku citohet* Urdhri për Zhdëmtim, para. 200.